

VENDIM I
ORTAKUT TË VETËM
TË
“KISS FM SHPK”

Sot, më datë 05.04.2023, unë i nënshkruari **Gentian Sula**, shtetas shqiptar, lindur më 09.03.1983, mbajtës i pasaportës me numër personal I30309064B, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë **Kiss FM**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (“**QKB**”), me numër unik identifikimi të subjektit (**NUIS**): K92226026O dhe seli në adresën: “*Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kati 2, Tiranë, Shqipëri*” (në vijim referuar si “**Shoqëria**”),

MEQËNËSE:

- Unë jam ortak i vetëm i kuotës së Shoqërisë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të saj, me vlerën 5.000.000,00 (*pesë milion*) lekë;
- Dëshiroj që të transferoj kuotën time të zotëruar në Shoqëri, si kontribut i vlerësuar në para tek shoqëria Noa Holding Sh.p.k., me **NUIS: M31509039J**.

Për sa më sipër, në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, të ndryshuar, vendosa si vijon:

VENDOS:

1. Të transferoj kuotën time në Shoqëri, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerën 5.000.000,00 (*pesë milion*) lekë, në formën e kontributit të vlerësuar në para në shoqërinë Noa Holding Sh.p.k me **NUIS: M31509039J**.
2. Kuota do të përfshihet në formën e kontributit të vlerësuar në para në kapitalin e shoqërisë Noa Holding Sh.p.k., në përputhje me vlerën e saj nominale, siç gjendet aktualisht e

regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga QKB. Si pasojë e këtij kontributi, ortaku i vetëm i Shoqërisë, do të jetë shoqëria Noa Holding Sh.p.k.

3. Në përputhje me sa më sipër, ndryshohet neni 6 i statutit të Shoqërisë, si vijon:

“Kapitali Themeltar i Shoqërisë “Kiss FM Sh.p.k. përbëhet nga një kuotë me vlerën 5.000.000,00 (pesë milion) lekë, e zotëruar tërësisht nga Ortaku i Vetëm, Shoqëria Noa Holding Sh.p.k”

4. Të depozitohet këtë vendim si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm pranë QKB dhe pranë të gjitha autoriteteve ku ky depozitim është i nevojshëm.

ORTAKU I VETËM

GENTIAN SULA

Gentian Sula

A blue circular stamp with the text "KISS RADIO" inside. The word "KISS" is in a large, bold, stylized font, and "RADIO" is in a smaller font below it. The stamp is partially overlaid by a handwritten signature in blue ink that reads "Gentian Sula".